



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/50

Datë: 02.12.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nën paragrafit 3.1 të nenit 4 dhe paragrafit 5 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 dhjetor 2011, mori:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pronave të paluajtshme dhe zotëruesve të interesit të cilat ndodhen në Zonat Kadastrale të Komunave Lypjan dhe Graçanicë, dhe të cilat preken nga ndërtimi i shtyllave elektrike dhe vendosja e stabilimenteve për zgjerim të rrjetit energjetik dhe shpronësimin me vënien e të drejtës të servitutit në dobi të KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A) me kompensimin e dëmeve të pronarëve për ngastrat kadastrale, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Ministria e Financave e cila mbështetet nga Departamenti i Shpronësimit i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A) dhe Kuvendet Komunale në territorin e të cilave gjenden ngastrat kadastrale që duhet të shpronësohen.
3. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave, KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A) dhe Kuvendet Komunale në territorin e të cilave gjenden ngastrat kadastrale për zbatimin e këtij vendimi.
4. Mjetet financiare për kompensimin e shpronësimit ti sigurojë Subjekti Kërkues, Kompania KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A)

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Shpronësimit/Departament za Ekspropriaciju/Department of Expropriation

NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, dhe pikës Nr.3 të Vendimit të Qeverisë Nr. 05/50, Datë. 02.12.2011, njoftohen të gjithë subjektet në listën bashkëlidhur këtij njoftimi se:

1. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik të ndërtimit të autostradës Linjës Nr.112 110kV në Lipan dhe vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve të nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të Kosovës, mbas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, në vijim të kërkesës së bërë nga ana e Kompanisë Publike KOSTT(Operatori i Sistemit,Transmisionit dhe Tregut Sh.A). Qeveria në zbatim të ligjit të lartpërmendur, ka miratuar Vendimin Nr. 05/50, Datë 02.12.2011, për iniciimin e procedurave të shpronësimit për ndërtimin e Linjës Nr.112 110kV në Lypjan dhe zgjerimin e stabilimenteve për linjën e dyfishtë 110kV në Nën Stacionin Lipjan dhe vendosjen e shtyllave elektrike në Komunitat Lypjan dhe Graçanicë
2. Qeveria do të marrë një Vendim Preliminar mbi Ligjshmërinë e Shpronësimit të Propozuar, brenda 30-ditëve kalendarike, mbas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, lidhur me organizimin e dëgjimit/ve publik.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqesë komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin Shpronësues, brenda 10 ditëve kalendarike, mbas shpalljes së vendimit të Qeverisë Nr. 05/50, Datë 02.12.2011 për shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës për shpronësim, në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazete me tirazh të madh në Kosovë.
4. Qeveria do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e përhershëm dhe shpronësim më të drejtën e krijimit të serviturit të kërkuar për ndërtimin e Linjës Nr.112 110kV në Lipjan dhe zgjerimin e stabilimenteve për linjën e dyfishtë 110kV në Nën Stacionin Lypjan dhe vendosjen e shtyllave elektrike në Komunitat Lypjan dhe Graçanicë
5. Të gjithë personat të cilët janë zyrtarë publik të Komunës në të cilën mbahet dëgjimi publik apo pronarë ose zotërues të interesit në pronën e cila gjendet brenda kësaj Komune ose avokat apo përfaqësues të ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.

6. Çdo person i lartpërmendur do t'i jepet mundësi e arsyeshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2 deri 4 të nenit 9 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010.
7. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik duhet të sjellë me vete prova të arsyeshme (*dokumente*) të cilat dëshmojnë se ai/ajo është në fakt zyrtar publik, pronar ose zotërues i interesit ose avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik, Pronari ose Zotëruesi të Interesit.
8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda juridiksionit territorial të **Komunës së Lipjanit**, do të mbahet në **Datë 18 Janar 2012, Ora 10^{oo}, në sallën e Kuvendit të Komunës, përkatësisht për zonat kadastrale:**
 - a.) **Lypjan**
9. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar, të të drejtave private pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda juridiksionit territorial të **Komunës së Graçanicës**, do të mbahet në **Datë 17 Janar 2012, Ora 10^{oo}, në sallën e Kuvendit të Komunës, përkatësisht për zonën kadastrale:**
 - a.) **Graçanicë**
10. Në rast se prona e cila është objekt i kërkesës shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit të iniciuar në përputhje me atë kërkesë, asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmirësimi të bërë në pronë, objekteve të ndërtuara ose zgjeruara në pronë, ose pemëve apo bimëve të mbjellura në pronë pas datës së përmbylljes së dispozitave përkatëse të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010. Çdo person i cili pretendon se ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtojë Ligjit nr. 03/L-139 datë 26.03.2009 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 datë 28.10.2010, dhe të kërkojë ndihmë profesionale juridike për kuptimin e të drejtave të tyre sipas ligjit.
11. Çdo Person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon se zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në cilëndo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim menjëherë duhet të dërgojë në Organin Shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij/saj, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjet e certifikuara të çfarëdo dokumenteve që ndërlidhen me atë pretendim.